25

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me sekretaren juridike Shyhrete Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit A[illegible] J[illegible] nga [illegible] p.n, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378, parag.6 lidhur me par. 1 të KP-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.3210-8/16 të dt. 05.06.2017, për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 07.08.2017, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

A[illegible] J[illegible], nga i ati H[illegible] dhe e ëma Xh[illegible], me vendbanim në P[illegible] p.n., ka kryer shkollën e mesme i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion kamarier, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [illegible]

Ë SH T Ë FA J T O R

Me datën 20.10.2016 rreth orës 11:40 minuta, në P[illegible], me saktësisht duke lëvizur në rrugën [illegible], duke e shkelur ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54, të ligjit për sigurimin në komunikacion rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa venë ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar motoqikleten e tij të llojit " Kawasaki", ngjyra e bardhë, pa targa të regjistrimit, kur arrin në vendin kritik, gazi i motoqikletes se tij bllokohet ne çrast i njëjti lëshon motiqkileten e tij nga duart dhe rrëzohet së bashku me të dëmtuarin-djalin e tij Ishulli Jelliqi, dhe si pasojë e rrëzimit, i dëmtuari djali i tij pëson lëndime të lehta trupore me dëmtim te përkohshëm të shëndetit.

Kështu që ka kryer veprën penale rrezikim i trafiku publik nga neni 378. parag.6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 493 dhe 495 të KPP-së lëson këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

PRANOHET KËRKESA e Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP/II.nr.3210-8/16 të dt. 05.06.2017.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 41, 43, 46, 73 të KP-së, të akuzuarit i'a shqipton:

DENIMIN ME GJOBË

Në shumën prej prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) €,** të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata dënimin e shqiptuar me gjobë do t'ia zëvendësoj me denim burgu duke ia llogaritur me nga 20 euro për një ditë burgimi, përkatësisht 7 (shtatë) ditë burgim, konform nenit 46 të KPK-së.

I dëmtuari i mitur [illegible] nga Prizreni rr. [illegible] pa.nr, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës për ekspertizën mjekoligjore 20 euro, për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 40.88 euro si dhe për paushallin gjyqësore shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë gjykatë, ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.3210-8/16 të dt. 05.06.2017, kundër të akuzuarit A[illegible] nga Prizreni [illegible] p.n, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378, parag.6 lidhur me par. 1 të KP-së. Aktakuzës i'a ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të akuzuarit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të besueshme se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Dhe konform nenit 493 të KPP-së, kërkoi që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor të lëshoj urdhërin ndëshkimor me të cilin të akuzuarit do ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 parag.1 të KPP-së, dhe në kuptim të nenit 495 parag.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: në ekspertizat e komunikacionit dhe mjekoligjore, si dhe nga fotodokumentacioni si dhe në shkresat tjera të lëndës, u vërtetua se i akuzuari e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 451 parag.1 dhe 2 të KPP-së.

Me sa u tha me larte, në kuptim te nenit 495 parag.2 lidhur me parag.1 të KPP-së, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1257/17 me datë 07.08.2017.

Sekretarja juridike,
Shyhrete Sopaj

Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në këtë gjykatë. Në qoftë se i akuzuari nuk paraqet kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.